



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjilan
Gilan Belediyesi

Në mbështetje të nenit 17 shkronja s) të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 38, paragrafi 1.4, të Statutit të Komunës së Gjilanit 01.nr. 16-126211 datë 06.11.2014, në nenin 4 të Rregullores për procedurat dhe kriteret e vendosjes të Përmendoreve, shtatoreve, Busteve dhe Simboleve dhe Rekomandimit të Komitetit për Politike dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur më 30.03.2017, merr

VENDIM

Për miratimin e Fjalësit të emrave të personaliteteve dhe ngjarjeve nga territori i Komunës së Gjilanit dhe tërësia etnike shqiptare, por edhe nga bota

1. Me këtë vendim miratohet Fjalësi i emrave të personaliteteve dhe ngjarjeve nga territori i Komunës së Gjilanit dhe tërësia etnike shqiptare, por edhe nga bota i hartuar nga Këshilli Komunal për Vlerësimin e Meritave Historike e Shoqërore të Personaliteteve dhe Ngjarjeve nga Territori i Komunës së Gjilanit, tërësia etnike shqiptare dhe më gjerë i formuar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Gjilanit
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Fjalësi i emrave të personaliteteve dhe ngjarjeve nga territori i Komunës së Gjilanit dhe tërësia etnike shqiptare, por edhe nga bota
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet ekzekutivi i Komunës, përderisa për implementimin e tij do të kujdeset Kryesuesja e KK-Gjilan.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL- s dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01.Nr.016-31877
Gjilan, më 30.03.2017

Kryesuesja e Kuvendit

Valentina Bunjaku-Rexhepi